

Dr. Musli Vërbani

**EMËRTONI FËMIJËT TUAJ ME EMRA TË
BUKUR**

Kaçanik, 2011

Autor:
Dr. Musli VËRBANI

Titulli:
EMËRTONI FËMIJËT TUAJ ME EMRA TË BUKUR

Korrektura:

.....

*Radhitja kompjuterike,
kopertina dhe dizajni grafik*
Mumin Shehu

Botues: Autori

Shtypi:
“FokusPrint”, 2011

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

*“Ju do të thërreni me emrat tuaj dhe të
baballarëve tuaj.” (Hadith)*

TE DREJTAT E FËMIJËS NE ISLAM

Fëmijët në islam janë qetësim i shpirtit, lumturi e jetës, lule e familjes, zbulim i shoqërisë. Për këtë Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

“Edhe ata që thonë: “O Zoti ynë, na dhuro gëzim në gratë dhe fëmijët tanë, dhe na bën neve shembull për të devotshmit.”

(Furkan, 74)

Ne një ajet tjetër, Zoti i Madhërishëm thotë:

“Allahu krijon për ju femra të llojit tuaj, kurse prej grave tuaja u jep djem e nipër, ju furnizon me sende të bukura.”

(Nahl, 72)

Për këtë arsye Islami i ka dhënë rëndësi të posaçme fëmijëve dhe i ka paraparë të drejtat e fëmijës, para dhe pas lindjes.

TE DREJTAT E FËMIJËS PARA LINDJES NE ISLAM

1. QË FËMIJA TE LIND PREJ PRINDËRVE TË MARTUAR SIPAS LIGJIT ISLAM.

Sepse jeta në martesë i obligon që të dy prindërit t'ua sigurojnë jetën fëmijës së tyre.

2. QE PRINDËRIT TË JENË TË NJË FEJE (ISLAME).

Për këtë arsye Zoti i Madhërishëm në Kur'an thotë:

“Mos u martoni me politeiste (idhujtare) deri sa të bëhen besimtare, nuk ka dyshim se robëresha besimtare është më e mirë se politeistja (idhujtarja) edhe sikur të ju pëlqejë ajo.”

(El-Bekare, 221)

Pra, e drejtë e fëmijës është që prindi t'ia zgjedhë nënën e mirë, prej fesë se pastër Islame, siç thotë i Dërguari i Allahut në hadithin të cilin e transmeton Buhariu dhe Muslimi:

“Martoju me atë që është fetare, se përndryshe të rrokë varfëria.”

3. TË MOS URREJË QË FËMIJA I TIJ TË LINDË VAJZË, PRA, I GJINISË FEMËRORE.

Arabët paraislamikë e kanë pasur zakon që kur fëmija t'i lindte vajzë, ta varrosnin për së gjalli, ngase, sipas tyre,

femra sjell turp në familje. Mirëpo, Islami e ka nderuar, e ka respektuar dhe e ka ngritur gjininë femërore në vlerën të cilën e meriton, ndërsa, atyre të cilët vepruar këto krime ua ka ndaluar rreptësisht, dhe një gjë të tillë të mos e përsërisin më kurrë. Allahu i Madhëruar në Kur'an thotë:

“Kur ndonjëri prej tyre lajmërohet me (lindjen) vajzë, fytyra e tij prishet dhe bëhet plot mllef.

Fshihet prej njerëzve, për shkak të asaj të keqeje me të cilën u lajmërua (e konsideron bela, e jo dhuratë prej Zotit). Mandej, (mendon) a do ta mbajë atë, ashtu i përlulur, apo do ta mbulojë atë (të gjallë) në dhe. Sa i keq është ai gjykim i tyre.”

(En-Nahl, 58-59)

4. PËRGATITJA E FËMIJËS PARA SE TË LIND.

Fëmija është lule e familjes, ai i forcon edhe me shumë marrëdhëniet bashkëshortore.

Prindërit duhet të përgatiten që fëmijën e tyre ta edukojnë mirë, ndërsa sa i përket furnizimit, furnizimi është në dorën e Allahut. Ata janë të detyruar të angazhohen që sa me shumë të sjellin lumturi ne jetën e tyre, së bashku me fëmijën dhe me pasurinë të cilën e posedojnë. Thotë Zoti i Madhëruar:

“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj botë.”

(El-Kehf, 46)

Gjithashtu fëmija u sjell të mira prindërve të tij edhe pas vdekjes së tyre.

Muhamedi a.s. në hadithin të cilin e transmeton

Muslimi nga Ebu Hurejre thotë:

“Kur të vdes biri i Ademit (njeriu) i ndërpriten shpërblimet e kësaj bote, përpos në tre raste:

- *“Nga lëmosha qarkulluese,*
- *dituria me te cilën shërbehen dhe kanë dobi të tjetër, dhe*
- *fëmija i mirë i cili lutet për të.”*

Pra, fëmija është mirësi e kësaj dhe e botës tjetër.

TË DREJTAT E FËMIJËS PAS LINDJES

1. THIRRJA E EZANIT NË VESHIN E DJATHTË DHE THIRRJA E IKAMETIT NË VESHIN E MAJTË.

Kjo e drejtë e fëmijës është për arsye se ai kur të vjen në këtë botë, fjalët e para që do t'i dëgjojë të jenë fjalët: *Allahu Ekber* dhe *La ilahe il-lall-llah*, dhe me qëllim që edhe fjala e fundit, pra, duke u ndarë nga kjo botë, të jetë fjala: *La ilahe il-lall-llah*.

Transmeton Ebu Davudi dhe Tirmidhiu se:

“Kur Fatimja r.a. (vajza e Muhamedit a.s.) e ka lindur Hasanin, I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ia ka kënduar ezanin në vesh.”

Pas kësaj prindi e pret një dash apo dele kurban për fëmijën që në Islam quhet AKIKË. Disa dijetarë thonë se Akiki (prerja e kurbanit për fëmijën) është vaxhib.

Me mishin e kurbanit (Akikit) përgatitet një ushqim dhe pastaj ftohen farefisi, fqinjët, dashamirët, të cilët pas

ushqimit bëjnë lutje që fëmija të zhvillohet mirë, të jetë i edukuar, i sjellshëm me prindërit e tij dhe të tjerët .

Lejohet të huazosh para për ta prerë Akikin, por nëse nuk ke, atëherë mund të përgatitësh çfarëdo lloj ushqimi për t'i ushqyer musafirët, nëse edhe këtë nuk e ke, atëherë mirë është të japësh sadaka.

Është e ndaluar, siç veprojnë të ne, që pasi të lindë fëmija prindi të qerasë alkool apo gjera të cilat janë të ndaluara në Islam.

Gjithashtu, tek ne ka qenë traditë që kur dikujt i ka vdekur ndokush, e kanë pre lopën që kanë pasur dhe me të, para se ta varrosin të vdekurin, kanë përgatitur ushqim për ata që prezantojnë në përcjelljen e kufomës. Këtë edhe sot e praktikojnë në disa vende. Por, duhet t'a dimë se prerja e kurbanit dhe përgatitja e ushqimit bëhet kur të lind fëmija. Ndërsa, kur të vdesë ndokush, atëherë farefisi dhe fqinjët e tij duhet të përgatisin ushqim për familjen e të vdekurit, e jo familja e të vdekurit të përgatisë ushqim për të tjerët.

2.E DREJTA E EMËRTIMIT TË FËMIJËS DHE PËRKATËSISË SE TIJ

Transmeton Ebu Davudi nga Ebu Hurejre se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Në Ditën e Kijametit ju do të thirreni me emrat e juaj dhe me emrat e prindërve tuaj.”

Po ashtu transmeton Muslimi nga Ibn Amri se

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Emrat me të dashur te Allahu janë: Abdullah dhe Abdurrahman.”

Nga kjo kuptojmë se disa emra janë te ndaluar, siç janë emrat e shejtanëve, idhujtarëve e pabesimtarëve. Disa emra janë të dashur te Allahu, e disa janë te ndaluar. Për këtë do të flasim më gjerësisht me vonë.

3. E DREJTA E GJIDHËNIES

Nëse fëmija nuk ka nënë, prindi e ka për obligim t’ia sigurojë fëmijës gjidhënien (nga ndonjë grua tjetër me kompensim).

Nëse nëna është gjallë, atëherë ajo duhet t’i japë gji fëmijës së saj. Thotë Zoti i Madhëruar:

“Nënat u japin qumësht fëmijëve të tyre dy vjet të plota nëse dëshirojnë ta plotësojnë saktësisht gjidhënien.”

Nëse nëna dëshiron ta ndërpresë gjidhënien para dy viteve, kjo duhet të behet me marrëveshjen në mes dy prindërve të fëmijës.

“... E nëse pas një konsultimi dhe pëlqimi (prindërit) shfaqin dëshirën për ndërprerjen (më herët) e gjirit, nuk është ndonjë mëkat për ta...”

(El-Bekare, 233)

Nëna mund ta ndërpresë gjidhënien nëse shëndeti i saj është në rrezik apo nëse nëna është dobësuar shumë.

Thotë Zoti i Madhëruar:

**“... Asnjë nënë nuk bën të dëmtohet me fëmijën e saj,
...”**

(El-Bekare, 233)

Prindi, siç thamë, duhet të sigurojë grua për t'i dhënë qumësht fëmijës me kompensim, ose, nëse ndodhë shkurorëzimi, ai duhet që bashkëshortes se shkurorëzuar, e cila i jep qumësht fëmijës, t'i japë kompensim.

Thotë Zoti i Madhëruar:

“Nëse (bashkëshortet e shkurorëzuara) i japin qumësht fëmijëve të juaja dhe të tyre, atëherë jepni atyre pagesën e merituar. Këshillohuni në mes vete për të mira. Nëse kjo nuk arrihet, atëherë qumësht le t'i japë (fëmijës) ndonjë grua tjetër.”

(Et-Talakë, 6)

Nëse një grua i jep qumësht fëmijës së gruas tjetër, atëherë ajo bëhet nënë për nga qumështi.

4. E DREJTA E SYNETLLËKUT

Synetllëku për fëmijën është vaxhib ne Islam. Synetllëkun e kanë praktikuar edhe pejgamberet e mëhershëm, sepse me të ruhet pastërtia dhe shëndeti i trupit.

Transmetohet nga Ebu Hurejre në Sahihun e Buhariut dhe te Muslimi se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Pesë çështje janë natyrshme të njeriut: Synetllëku, shkurtimi i mustaqeve, prerja e thonjeve, të rruarit e nënsqetullave dhe të rruarit në pjesët e turpshme të njeriut.”

Nëse fëmija nuk behet synet kur të jetë i vogël, ai

duhet të behet synet vetë kur të rritet. Po ashtu, edhe ai i cili e pranon Islamit, edhe nëse është i rritur apo në çfarëdo moshe të jetë, behet synet.

I pari i cili është bërë synet, në moshën 80 vjeçare, është Ibrahim a.s.

5. E DREJTA E SIGURIMIT TË ZHVILLIMIT TË JETËS SË FËMIJËS

E drejtë e fëmijës është që ai të sigurohet nga çdo gjë që e dëmton, qoftë fizikisht apo mentalisht. Për këtë arsyeje Muhamedi a.s., në hadithin të cilin e transmeton Ebu Davudi nga Ibn Umeri, thotë:

“Mjafton për njeriun të bëhet gabimtar vetëm pse atë që kujdeset nuk e ushqen.”

Pastaj Muhamedi a.s. thotë:

“Secili prej juve është bari dhe secili do të përgjigjet për tufën e tij. Njeriu është bari në shtëpinë e tij, ai do të përgjigjet për familjen (fëmijët) e tij.”

(Buhariu)

Fëmija nëse rritet dhe zhvillohet, ai do të bëhet i shëndoshë, do t'i ndihmojë familjes dhe shoqërisë, për këtë Muhamedi a.s. thotë:

“Besimtari i shëndoshë dhe i fuqishëm është me i dashur te Allahu se besimtari jo i shëndoshë dhe i dobët.”

6. E DREJTA E KUJDESIT FAMILJAR

Kujdesi ndaj fëmijës është obligim ndaj Allahut dhe robit të tij. Nëse fëmija i ka prindërit, prindërit e kanë për obligim ta ushqejnë, ta veshmbathin, ta pastrojnë derisa të rritet.

Nëse bashkëshortët ndahen (shkurorëzohen), atëherë kujdesin për fëmijën e merr nena derisa të rritet, ndërsa kur të rritet fëmija, atëherë fëmija me dëshirën e tij zgjedh se ku të shkojë dhe nën kujdesin e cilit prind të jetojë, apo të jetojë i pavarur.

7. E DREJTA E POROSISË PËR MBIKËQYRJE PARA VDEKJES SË PRINDËRVE

Mbikëqyrës apo kujdestar i fëmijës është prindi (babai) derisa ai të jetë gjallë. Nëse ai mungon (vdes), mbikëqyrja i takon babait të prindit të fëmijës (gjyshit të fëmijës). Nëse edhe ai mungon, atëherë mbikëqyrja kalon tek vëllai (i prindit të fëmijës). E nëse edhe ai mungon, atëherë mbikëqyrja kalon te axha (i prindit të fëmijës). Pra, e drejta e mbikëqyrjes kalon në të njëjtën renditje si në trashëgimi.

Mbikëqyrja ndaj fëmijës nënkupton kujdesin për ushqim, veshmbathje, kujdesi për edukim, arsimim, shërim dhe çdo gjë që ka nevojë fëmija.

8. E DREJTA E EDUKIMIT DHE ARSMIMIT

Muhamedi a.s. thotë:

“Mësoni fëmijët tuaj, edukoni mirë dhe arsimoni mirë.”

Nuk ka dyshim se edhe rrethi ku jeton fëmija ndikon shumë në edukimin e tij. Muhamedi a.s., në hadithin të cilin e transmeton Buhariu, thotë:

“Çdo fëmijë lind në fenë e pastër islame, por prindërit e tij e bëjnë judhi, të krishterë ose zjarrputist (idhujtar).”

Taberani transmeton hadithin ku Muhamedi a.s. thotë:

“Mësojani fëmijëve tri çështje:

- Ta duan të Dërguarin e Allahut;

- Familjen e tij; dhe

- Ta lexojnë Kur'anin, sepse njohja e Kur'anit do t'i jetë hije nën Arshin e Madh në atë Ditë (Ditën e Kijametit) kur nuk ka hije pos asaj hije, dhe do të jete me pejgamberët dhe të dashurit e Allahut.”

Po ashtu fëmija duhet të mësohet ta falë namazin. Muhamedi a.s. thotë:

“Urdhëroni fëmijët tuaj të falin namaz kur t'i mbushin shtatë vjet. Ndërsa kur t'i mbushin dhjetë vjet, nëse nuk falen, rrihni, dhe pas kësaj moshe ndani fëmijët djem nga vajzat që mos të flenë në një shtrat.” (Hakimi dhe Ebu Davudi)

Prindi duhet të interesohet që fëmija i tij me kë

shoqërohet. Muhamedi a.s. thotë:

“Njeriu është në fenë e shokut të tij. Andaj shikoni se cilin e keni shok (zgjidhni shoqëri të mirë).” (Tirmidhiu)

Pas të gjitha këtyre, fëmija duhet te mësohet të shkojë në xhami, që aty të pajiset me njohuri fetare.

Transmeton Muslimi se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Çdo herë kur të mblidhet një popull (grumbull njerëzish) në një shtëpi prej shtëpive të Allahut (në një xhami) për të lexuar Kur'an dhe studiuar, dhe për t'u konsultuar dhe shqyrtuar çështjet e tyre, atëherë Zoti zbret qetësi, siguri dhe lumturi mbi ta, i mbulon me mëshirën e Tij, ndërsa melaqet luten për ta dhe Zoti i regjistron në regjistrin e të mirëve.”

10. E DREJTA E SHKOLLIMIT

E drejtë e fëmijës është gjithashtu edhe e drejta e shkollimit. Shkollimi i fëmijës nuk përkufizohet vetëm në shkencat fetare, por shkollimi përfshin të gjitha shkencat, si ato fetare, shoqërore, ekonomike, ekzakte dhe çdo lëmi që i nevojitet atij për të fituar lumturinë edhe në këtë botë edhe në botën tjetër. Kështu tek fëmija tubohen dy çështje me vlerë të madhe: Mendja e shëndoshë në trupin e shëndoshë.

11. E DREJTA E SHËNDETIT DHE E SHËRIMIT

Nuk ka dyshim se preventiva është me e mirë se përdorimi i ilaçit. E drejtë e fëmijës është që prindi të kujdeset për të që mos të sëmuret. Për këtë fëmijës duhet t'i sigurohet ushqimi i mirë, veshmbathja e mirë dhe vendstrehimi i mirë. Përpos këtyre elementeve fëmija duhet të jetë vazhdimisht i pastër, që të jetë i mbrojtur nga viruset dhe mikrobet. Për këtë fëmija duhet të mësohet për pastrimin e trupit (gusulin), pastrimin e pjesëve të trupit (abdestin), pastaj për prerjen e thonjve vazhdimisht. Gjithashtu prindi duhet ta bëjë fëmijën synet.

12. E DREJTA E TRASHËGIMISË

Të gjithë dijetarët islam janë të pajtimit se fëmija ka të drejtë trashëgimie edhe nëse është para lindjes. Nëse njeriu vdes dhe gruan e lë shtatzënë, atëherë fëmijës i rezervohet trashëgimia e tij dhe kur të rritet i dorëzohet në duart e tij.

Zoti i Madhëruar në Kur'an thotë:

“... Dhe kur të arrijnë moshën e pjekurisë dorëzoni pasuritë e tyre. Dhe mos shpenzoni pa nevojë derisa ata te rriten. Kush është i pasur le të përmbahet, e kush është i varfër le të shpenzojë me masë aq sa i nevojitet. E kur t'ua jepni pasurinë e tyre, jepjani me dëshmitarë. Dhe mjafton se, me siguri para Allahut jepet llogaria.”

(En-Nisa, 6)

13. E DREJTA E MENDIMIT TË LIRË

Sheriati islam e respekton mendimin e fëmijës, nëse ai

ia qëllon dhe ka mendim të drejtë.

Islami i edukon fëmijët që ata të bëhen të pavarur në mendimet e tyre, si në aspektin e diturisë, profesionit... etj.

14. E DREJTA E ARGËTIMIT

Argëtimi në jetën e fëmijës ka përparësi nga mësimi, mirëpo argëtimi, në rend të parë, duhet të jetë nën kujdesin e familjes, **pastaj me të mëdhenjtë dhe të vegjlit.** Loja i ndihmon fëmijës në zhvillimin e trupit të tij.

15. E DREJTA E FËMIJËS NË KURBET

Transmeton Hakemi se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Edukoni fëmijët tuaj që ta duan Allahun dhe të Dërguarin e Tij.”

Gabimin apo mëkatin për mos mësimin e Islamit dhe përkatësisë fëmijës në kurbet e merr prindi, pastaj shteti, i cili nuk kujdeset që t’i ofrojë atij mësimet se si ta dojë fenë e tij, atdheun e tij, familjen e tij, kombin e tij.

Fëmija në kurbet është si zog në vend të huaj. Ai zog një ditë duhet të kthehet në vendlindje, ai duhet t’i dijë prejardhjen dhe origjinën e tij. Ai zog nuk duhet të humbas, nuk duhet të shkojë në rrugë pa kthim. Këtë përgjegjësi e ka shoqëria, e cila duhet të sigurojë në kurbet mësimet speciale për ta, që ata të bëhen si ambasadorë (të deleguar) të atdheut të tyre në vend të huaj.

16. E DREJTA E ZGJEDHJES SË SHOKUT TË JETËS (BASHKËSHORTIT - BASHKËSHORTES)

Pasi që fëmija të arrijë moshën e pjekurisë, pa marrë parasysh a është mashkull apo femër, ka të drejtë në zgjedhjen e shokut të jetës dhe nuk lejohet që prindi ta detyrojë djalin të martohet me vajzën e cila nuk i pëlqen, ose në të kundërtën, ta detyrojë vajzën të martohet me djalin që nuk i pëlqen. Prindërit kanë të drejtë të intervenojnë vetëm atëherë kur ka ndonjë pengesë apo ndalesë e sheriatit që pengon martesën, në të kundërtën jo.

17. E DREJTA E JETËS NE BASHKËSI APO NË SHOQËRI (E DREJTA E MOSIZOLIMIT)

Me këtë të drejtë kemi për qellim që fëmijës t'i sigurohet jeta e lumtur, pa presione, pa dhunë, pa keqtrajtime, pa cenim, pa anashkalim, dhe kjo duhet të jetë prej të gjithë muslimanëve. Muhamedi a.s. në një hadith thotë:

“Muslimanet të drejte janë në mes tyre dhe ata i ndihmojnë më të dobët.”

18. E DREJTA E PËRGJEGJËSISË

Nuk ka dyshim se fëmija duhet të këshillohet që të veprojë punë të mira nëse nuk vepron punë të mira dhe të këshillohet të largohet prej punëve të këqija nëse vepron punë të këqija. Këtë e bazojmë në hadithin e Muhamedit a.s. të cilin e transmeton Muslimi:

“Kush prej jush e sheh një të keqe le ta largojë me dorën e tij; nëse nuk mundet, atëherë me gjuhen e tij; nëse edhe kështu nuk mundet, atëherë me zemrën e tij, por kjo është shkalla me e ulët

e besimit.”

“EMËRTIMI I FËMIJËVE NË RRETHANA DHE ETAPA TË NDRYSHME”

Nëse i bëjmë një vështrim emrave, shohim se shumë emra janë deformuar, si nga jehuditë, serbët, maqedonasit, etj. ...

Kështu p.sh. kemi emra islamë që i kanë deformuar dhe i kanë dhënë prapashtesën “USH” të jehudive, si p.sh.:

- **Emrat e devijuar nga jehuditë**

Emri i devijuar	Emri në gjuhën arabe
KADRUSH	KADRI
QAMUSH	QAMIL
FAHRUSH	FAHRUDIN
EMRUSH	EMRI
FATUSHE	FATIME
SADUSH	SADIK
ALUSH	ALI
HAVUSH	HAVA
HAJRUSH	HAJRI
RAMUSH	RAMI
HAMDUSHE	HAMDI

- **Emrat e devijuar nga maqedonasit**

Maqedonasit, jo vetëm mbiemrat, por edhe emrat, i kanë deformuar duke ia shtuar prapashtesën “OV”, ashtu siç kanë vepruar bullgarët, si p.sh.:

Emri i devijuar	Emri në gjuhën arabe
-----------------	----------------------

ABDIOV
SALIOV
KERIMOV
HASANOV

ABDI
SALI
KERIM
HASAN

- **Emrat e devijuar nga serbët**

Te serbet e kemi të njëjtën çështje. P.sh. të njëjtat emra apo mbiemra i kanë deformuar duke ia shtuar prapashtesën “**VIQ**”:

Emri i devijuar	Emri në gjuhën arabe
ABDIOVIQ	ABDI
SALIOVIQ	SALI
KERIMOVIQ	KERIM
HASANOVIQ	HASAN

- Përpos këtyre, te ne shohim emra **grekë**, p.sh. TEODOR, NIKOLLË (KOLË), PJETËR, KATERINË (KATE), DORA, GJERGJ, ANASTAS, etj...

- Pastaj emra **romakë**: PAL, ANTON, GJON, ZEKË, MERI. Këta emra i kanë trajtat e tyre të lashta: PAULUS, ANTONIUS, JOSEPHUS, JOHANNES, MARIA.

- Pastaj kemi edhe emra **hebraikë**, si: JAKOV, TOME, etj...

- Në emërtimin e fëmijëve ka pasur ndikim edhe **sporti**. Kështu p.sh. në kohën e sodit shohim emra, si MARADONA, RONALDO, me qëllim që të bëhen fëmijët futbollistë si Maradona e Ronaldo...

- Pastaj emërtimi i fëmijëve me emra nga ngjarjet apo

figurat **politike**, si: INDIRA (Indira Gandi), ZHAKLINA (emri i gruas së kryetarit të Sh.B.A-ve XHON KENEDIT, e cila ka qenë e njohur për aventura.

- Pastaj emërtimi i fëmijëve me emra të **artistëve**, si: ELIZABETE (Elizabeta Tejllor), ESTER (Ester Uliams), RITA, MADONA etj...

- Pastaj emërtimi i fëmijëve me emra nga **literatura**, si: EDMOND, XHULIETE, ROMEO, ANTIGONA etj...

- Në një kohë kur prindërit tanë ishin **komunistë** të përbetuar, filluan t'i emërtonin fëmijët e tyre me emrat, si: BASHKIM, VËLLAZËRIM, etj., duke pasur për qëllim bashkimin dhe vëllazërimin e përgjithmonshëm me serbët, të cilët kurrë nuk ia kishin dashur te mirën popullin tonë.

- Të tjerët emërtojnë fëmijët me emra te **poetëve**, si: MIGJEN-(Millosh Gjergj Nikolla), ASDRENI (Aleksandër Stavre Drenova), NOL (Fan Noli), BUZUK (Gjon Buzuku) etj.

- Të tjerët i emërtojnë fëmijët me emra nga **bota shtazore**, si p.sh.: DRENUSHA, UJKAN, UKE, LUAN etj., me qëllim që fëmijët e tyre të bëhen si luan, ujk e drenushë.

- Të tjerët i emërtojnë fëmijët me emra nga **bota bimore**, si p.sh.: MIMOZË, VJOLLCA, MANUSHAQE, RRUSHE, LULE, BURBUQE, etj.

- Disa i emërtojnë fëmijët me emra të **trupave qiellore**,

si p.sh.: HËNË, YLLKË, DIELLZA, etj.

- Disa fëmijët i emërtojnë me emra të **fenomeneve natyrore**, si p.sh.: BORË, VETON, VULLKAN, VALTON, AGIM, SHKREPTIM, etj.

- Të tjerët i emërtojnë me emra të **ngjyrymeve emocionale** të gëzimit ose të dëshpërimit, si p.sh.: GËZIM, DËFRIM, FITIM, FITORE, DURIM, SHPËTIM, SHPRESË, VULLNET, DËSHPËRIM, ARGËTIM, etj.

- Disa i emërtojnë fëmijët me **emra të vendeve** apo me emra gjeografik, si p.sh.: SARANDA, VALBONE, ADRIATIK, VJORË, VJOSA, ARTE, ERENK, etj.

- Disa të tjerë i emërtojnë me emra nga **gurra popullore**, si p.sh.: AGRON, BATON, DARDAN, DAFINA, DRILON, GRANIT, FLAMUR, JETON, KUJTIM, KUSHTRIM, KRESHNIK, KALTËRINË, etj.

SI TE VEPROJMË KUR TE LIND FËMIJA

Është e rregull i përgjithshëm në Fikhun Islam se:
“Veprat shpërblehen sipas qëllimit.”

Çdo prind, për çfarë qëllimi e emëron fëmijën e tij, ai ashtu edhe do të shpërblehet.

Gjithashtu çdo prind është i urdhëruar që ta emërojë fëmijën e tij me emër të mirë, dhe e ka të ndaluar që ta emërojë fëmijën e tij me emër të keq ose me emër me kuptim të egër.

Pra, ne mund t'i klasifikojmë emrat të cilët janë të dashur dhe të pëlqyer prej Allahut.

- Në rend të parë janë emrat: ABDULLAH dhe ABDURRAHMAN, dhe çdo emër që fillon me ”ABD”, e pastaj i shtohet njëri prej nëntëdhjetë e nëntë emrave të bukur të Allahut, të cilat do t'i i shënojmë më vonë.

- Emrat të cilat e kanë esencën e tyre “HAMD” (Falënderim), si p.sh.: AHMED, MUHAMED, HAMID, etj.

Ka emra të cilët janë të ndaluar rreptësisht, si p.sh.: Abdulharith (Rob i shejtanit), ose Shejtan, Djall, Dreq; siç janë të ndaluar edhe emrat e pabesimtarëve dhe idhujtarëve.

Përpos këtyre, emra të tjerë as nuk janë të ndaluar, por as nuk janë emra të pëlqyer ose të urdhëruar.

- Kur të lind fëmija në rend të parë ia këndojmë ezanin në veshin e djathtë dhe ikametin në veshin e majtë.

Transmeton Davudi dhe Tirmidhiu nga Ebi Rafie se Muhamedi a.s. ia ka kënduar ezanin në vesh të Hasanit kur ka lind prej vajzës se tij, Fatimes.

- Pastaj, duke e falënderuar Allahun dhe duke shprehur gëzimin për fëmijën duhet të premtojmë që atë fëmijë ta edukojmë në frymën Islame. Gjithashtu të bëjmë lutje me dëshirë që ai fëmijë të jetë i mbrojtur prej shejtanit të mallkuar, që ai kurrë mos ta mashtrojë.
- Për këtë arsye edhe para marrëdhënies me bashkëshorten është mirë të thuhet duaja: *“Allahume xhennibish-shejtane ve xhennibish-shejtane ala ma rezektena”*, që d.m.th.: *“O Zoti im, largoje shejtanin nga ne dhe largoje nga embrioni.”* Nëse nga ky kontakt bashkëshortorë fillon krijimi i fëmijës, atëherë ky fëmijë do të jetë i mbrojtur nga shejtani, i cili nuk do të mund ta mashtrojë.
- Transmetohet nga Ebu Musa r.a. se: *“Kur i ka lindur një fëmijë e ka dërguar te Muhamedi a.s. dhe ai e ka emëruar Ibrahim dhe ia ka vendosë hurmën në buzë dhe është lutur që ai fëmijë të jetë i bereqetshëm.”* (Buhariu dhe Muslimi). Nëse nuk ka hurme, mirë është vendosja e ndonjë ëmbëlsire në buzët e fëmijës.
- Pas shtatë ditësh ia qeth flokët fëmijës, pret akikë (kurban), dhe e emëron fëmijën. Me akikin (kurbanin)

përgatit ushqim dhe i fton të afërmit, dashamirët dhe pas ngrënies luten për bereqet dhe mirësi për fëmijën. Disa dijetarë prerjen e akikut (dashit ose deles) e konsiderojnë vaxhib. Transmeton Ajsha r.a. se për djalë prehen dy dele, ndërsa për vajzë një dele. Ky mendim bazohet në ndarjen e trashëgimisë (me rastin e vdekjes së prindit) se djali merr dy hise, ndërsa vajza merr një hise.

JU DO TË THIRRENI NË DITËN E KIJAMETIT ME EMRAT TUAJ DHE ME EMRAT E BABALLARËVE TUAJ

Ebu Davudi nga Ebu Dardai transmeton hadithin:
“Emërtoni fëmijët me emra të bukur.”

Po ashtu transmeton Muslimi nga Ibn Umeri se Muhamedi a.s. ka thënë:

“Vërtet më së shumti Allahu i do emrat tuaj Abdullah dhe Abdurrahman.”

Tash do t'i tregojmë nëntëdhjetë e nëntë emrat e bukur të ALLAHUT dhe para secilit emër vihet fjala “ABD”, që ka kuptimin se ai fëmijë nuk i robërohet, nuk i nënshtrohet dhe nuk i përulet me fytyrë në tokë askujt tjetër përpos Krijuesit të tij:

Emri	Kuptimi në gjuhën shqipe
ABDULLAH	Rob i Allahut.
ABDURRAHMAN	Rob i Allahut të Gjithëmëshirshëm.
ABDURRAHIMË	Rob i Allahut Mëshirëplotë.
ABDULMELIK	Rob i Allahut Sundimtar.
ABDULKUDDUS	Rob i Allahut të Shenjtë.
ABDUSSELAM	Rob i Allahut Paqëdhënës.
ABDULMUËMIN	Rob i Allahut Sigurues.
ABDULMUHEJMIN	Rob i Allahut i cili Mbizotëron në mënyrë absolute çdo gjë.
ABDUL'AZIZË	Rob i Allahut të Plotfuqishëm, Triumfues.

ABDULXHEBBAR
ABDULMUTEKEBBIR
ABDULHALIK
ABDULBARI
ABDULMUSAVIR

Rob i Allahut *të Gjithëfuqishëm.*
Rob i Allahut *të Madhërishëm.*
Rob i Allahut *Krijues.*
Rob i Allahut *Fillues të çdo sendi.*
Rob i Allahut *i Cili jep formë dhe pamje çdo sendi.*

ABDULGAFFAR
ABDULKAHHAR
ABDULVEHHAB
ABDURREZZAK
ABDULFETTAH
ABDUL'ALIMË
ABDULKABID

Rob i Allahut *Gjithëfalës.*
Rob i Allahut *i Cili Mposhtë çdo gjë.*
Rob i Allahut *Dhurues.*
Rob i Allahut *Furnizues.*
Rob i Allahut *Zgjidhjedhënës.*
Rob i Allahut *të Gjithëdijshtëm.*
Rob i Allahut *i Cili e ka në dorë furnizimin dhe ia Ngushton kujt të dojë.*

ABDULBASIT

Rob i Allahut *i Cili e ka në dorë furnizimin dhe ia Zgjeron kujt të dojë.*
Rob i Allahut *i Cili Nënshtron dhe Përrulë të padrejt.*

ABDULHAFID

Rob i Allahut *Lartësues.*
Rob i Allahut *Ngritës.*
Rob i Allahut *i cili Nënshtron dhe degradon atë që do.*

ABDURRAFI'Ë

Rob i Allahut *Dëgjues.*

ABDULMU'IZ

Rob i Allahut *i Cili Vëren, Vështron dhe Sheh çdo send.*

ABDULMUDHIL

Rob i Allahut *Gjykues.*

ABDUSEMI'Ë

Rob i Allahut *të Drejtë.*

ABDULBESIRË

Rob i Allahut *të Butë.*

ABDULHAKEM

Rob i Allahut *të Gjithëinformuar.*

ABDUL'ADL

Rob i Allahut *Përdëllimtar.*

ABDUL-LETIFË

Rob i Allahut *Madhështor.*

ABDULHABIRË

Rob i Allahut *Falës.*

ABDULHALIMË

ABDUL'ADHIMË

ABDULGAFURË

ABDUSH-SHEKURË

ABDUL'ALIJJ

ABDULKEBIRË

ABDULHAFIDHË

ABDULMUKITË

ABDULHASIBË

ABDULXHELILË

ABDULKERIMË

ABDURR-RREKIBË

ABDULMUXHIBË

ABDULVASI'Ë

ABDULHAKIMË

ABDULVEDUDË

ABDULMEXHIDË

ABDULBA'ITH

ABDUSHEHIDË

ABDULHAKKË

ABDULVEKILË

ABDULKAVIJJ

ABDULMETINË

ABDULVELIJJ

ABDULHAMIDË

ABDULMUHSI

ABDULMUBDI

ABDULMU'IDË

ABDULMUHJI

ABDULMUMITË

ABDULHAJJ

Rob i Allahut *Mirënjohës.*

Rob i Allahut *të Lartë.*

Rob i Allahut *të Madh.*

Rob i Allahut *Ruajtës i çdo gjëje.*

Rob i Allahut *Ushqyes i çdo gjëje.*

Rob i Allahut *Cili i jep çdo send.*

Rob i Allahut *Fisnik.*

Rob i Allahut *Bujar.*

Rob i Allahut *Vigjilues.*

Rob i Allahut *i Cili pranon lutjet.*

Rob i Allahut *Gjithëpërfshirës.*

Rob i Allahut *të Urtë.*

Rob i Allahut *të Dashur.*

Rob i Allahut *të Lavdishëm.*

Rob i Allahut *Ringjallës.*

Rob i Allahut *Dëshmues.*

Rob i Allahut *të Vërtetit të*

Pamohueshmit.

Rob i Allahut *Përkujdesës për
furnizimin e të gjitha krijesave.*

Rob i Allahut *të Fortit me fuqi
absolute.*

Rob i Allahut *të Fortit të
Pathyeshmit.*

Rob i Allahut *nën Mbrojtjen e të Cilit
është gjithçka.*

Rob i Allahut *të Lavdëruar dhe
Falënderuar.*

Rob i Allahut *Gjithënjohës.*

Rob i Allahut *Nismëtar i çdo sendi.*

Rob i Allahut *i Cili Rikrijon çdo send.*

Rob i Allahut *Jetëdhënës.*

Rob i Allahut *Jetëmarrës.*

Rob i Allahut *të Gjallë.*

ABDULKAJJUM
ABDULVAXHID
ABDULMAXHID
ABDULVAHID
ABDUS-SAMED
ABDULKADIR
ABDULMUKTEDIR

ABDULMUKADDIM

ABDULMUEHHIR

ABDUL-EVVEL
ABDUL-AHIR
ABDUDH-DHAHIR
ABDULBATIN
ABDULVALIJ
ABDUMUTE'AL
ABDULBERR
ABDUT-TEVVAB
ABDULMUNTEKIM
ABDUL'AFUVV
ABDURR-RREUFË
ABDULMALIKULMU
LK

ABDUDHULXHELAL
I VEL-IKRAM
ABDULMUKSIT
ABDULXHAMI'Ë
ABDULGANIJ
ABDULMUGNI
ABDULMANI'Ë

Rob i Allahut *të Përjetshëm*.
Rob i Allahut *Kreator*.
Rob i Allahut *të Nderuar*.
Rob i Allahut *Një të Vetmit*.
Rob i Allahut *Strehimtar*.
Rob i Allahut *të Fuqishëm*.
Rob i Allahut i Cili *ka Mundësi për gjithçka*.
Rob i Allahut i Cili *i Paraprinë gjithçkaje*.
Rob i Allahut i Cili *Lë pas vete gjithçka*.
Rob i Allahut i Cili *është i Pari*.
Rob i Allahut i Cili *është i Fundit*.
Rob i Allahut *të Dukshmit*.
Rob i Allahut *të Padukshmit*.
Rob i Allahut *Udhëheqës*.
Rob i Allahut *të Gjithëllartësuar*.
Rob i Allahut *Mirëbërës*.
Rob i Allahut *Pendimpranues*.
Rob i Allahut *Ndëshkues*.
Rob i Allahut *Mëkatfalës*.
Rob i Allahut *të Dhembshurit*.
Rob i Allahut *Pushtetmbajtës*.

Rob i Allahut të Cilit i takon *Madhështia dhe Nderi*.
Rob i Allahut *Drejtësidhënës*.
Rob i Allahut *Tubues*.
Rob i Allahut *të Pasur*.
Rob i Allahut *Pasuridhënës*.
Rob i Allahut *Privues* (Ai pengon kë të dojë dhe çka të dojë).

ABDUD-DARRË

Rob i Allahut i Cili kur të Dëshirojë
t'i sjellë dikujt Dëm askush nuk mund
ta ndalë.

ABDUN-NAFI'Ë

Rob i Allahut Dobiprurës.

ABDUN-NURË

Rob i Allahut i Cili është Dritë.

ABDULHADI

Rob i Allahut Udhëzues.

ABDULBEDI'Ë

Rob i Allahut Shpikës.

ABDULBAKI

Rob i Allahut të Përhershëm.

ABDULVARITH

Rob i Allahut Trashëgues.

ABDURR-RRESHIDË

Rob i Allahut i Cili shpie në rrugë të
dobishme.

ABDUS-SABURË

Rob i Allahut Durimtar.

EMËRTIMI I FËMIJËVE ME EMRA TË PEJGAMBERËVE

Transmeton Vehbil Xhethmiu r.a. se Muhamedi a.s. ka thënë: *“Emërtoni fëmijët me emra të pejgamberëve.”*

Emri	Emri i pejgamberit
ADEM	Adem a.s.
IDRIS	Idrisi a.s.
NUH	Nuhi a.s.
HUD	Hudi a.s.
SALIH	Salihu a.s.
IBRAHIM	Ibrahimi a.s.
LUT	Luti a.s.
ISMAIL	Ismaili a.s.
IS`HAK	Is`haku a.s.
JAËKUB	Jaëkubi a.s.
JUSUF	Jusufi a.s.
SHUAJB	Shuajbi a.s.
MUSA	Musa a.s.
HARUN	Haruni a.s.
DAVUD	Davudi a.s.
SULEJMAN	Sulejmani a.s.
EJUB	Ejubi a.s.
JUNUS	Junusi a.s.
ZEKERIJA	Zekerija a.s.
JAHJA	Jahja a.s.
DHULKIFL	Dhulkifli a.s.
ILJAS	Iljasi a.s.
ELJESA	Eljesa a.s.
UZEJR	Uzejri a.s.
LLUKMAN	Llukmani a.s.

DHULKAR	Dhulkarnejni a.s.
NEJN	
ISA	Isa a.s.
MUHAMED	Muhamedi a.s.
	Pejgamberi i fundit.

EMËRTIMI I FËMIJËVE ME EMËR APO ME CILËSI TË DËRGUARIT TONË - MUHAMEDIT a.s.

Emri	Kuptimi i emrit
MUHAMED	I falënderuar, i lavdëruar.
AHMED	Ai i cili falënderohet, lavdërohet.
EMIN	Besnik.
MUDETHIR	Me këtë emër e ka thirr meleku Xhibril Muhamedin a.s.: <i>“O ti që je mbuluar”</i> .
MUZEMIL	Me këtë emër e ka thirr meleku Xhibril Muhamedin a.s.: <i>“O ti që je mbuluar”</i>
ABDULLAH	Rob i Allahut.
SHAHID	Dëshmitar i Allahut.
SHEHID	Dëshmitar, Dëshmor në rrugën e Allahut.
MUBESHIR	Lajmëtar për përgëzime.
NEDHIR	Tërheqës i vërejtjes.
MUNDHIR	Tërheqës i vërejtjes.
MUALIM	Mësues i fesë së pastër Islame.
FATIH	Çlirimtar prej errësirës në dritë.
NURI	Dritë.
SIRAXHULMU	Pishtar ndriçues.
NIRË	

HANIFE
MUBELIG
MUHI

Sjellës i fesë së pastër Islame.
Sjellës i komunikatës e Allahut.
Fshirës i pabesimin dhe sjellës i besimit.

TAHIR

Pastër në çdo aspekt, fizikisht dhe shpirtërisht.

SADIK
HADI

Vërtetues i fjalëve të Allahut.
Udhëzues në rrugën e drejtë dhe të vërtetë.

MUHTEDI

Udhëzues në rrugën e drejtë dhe të vërtetë.

EMRAT E FAMILJES SË MUHAMEDIT a.s.

Emri

Emri i prindërve

ABDULLAH
EMINE

Emri i babait të Muhamedit a.s.
Emri i nënës së Muhamedit a.s.

Emri

Emri i fëmijëve të Muhamedit a.s.

FATIME
KASIM

Nëna e Hasanit dhe Husejnit.
Ka për synim Tahir (i pastër) dhe Tajib (i mirë).

ABDULLAH
RUKIJE

Djali i parë i Muhamedit a.s.
Migruesja e dyfishtë (në Etiopi dhe Medine).

ZEJNEBE

Vajza më e madhe e Muhamedit a.s.

UMI
KULTHUM
IBRAHIM

Gruaja e Uthmanit r.a.

Po ashtu edhe emër i peygamberit Ibrahim a.s.

Emri	Emri i grave të Muhamedit a.s.
HATIXHE	Hatixhe bint Huvejlid.
SEVDE	Sevdete bint Zumatel Arimije.
AISHE	Aishe bint Ebi Bekr.
HAFA	Hafsa bint Umer.
ZEJNEB	Zejnebe bint Huzejne.
UMI SELEME	Umi Seleme bint Zadu Err-Rrekb.
UMI HABIBE	Umi Habibe Remlete bint Ebi Sufjan.
XHUVEJRIJE	Xhuvejrije bint el Harith el Hazaije
ZEJNEB	Zejnebe bint Xhahsh.
SAFIJE	Safijete bint Haji.
MEJMUNE	Mejmunete bint El-Harith El-Hilalijete.

EMËRTIMI I FËMIJËVE ME EMËR TË NJËRIT PREJ SAHABËVE (SHOKËVE BESNIK) TË MUHAMEDIT a.s.

Edhe pse sahabët - shokët e Muhamedit a.s. kanë qenë shumë dhe është e pamundur të paraqesim të gjithë, në këtë libër ne do të mundohemi t'i paraqesim vetëm një numër të tyre, me qëllim që fëmija të bëhet besnik, siç ishin shokët e Muhamedit a.s. besnikë.

Emri	Emri i shokëve të Muhamedit a.s.
BEKIR	Ebi Bekr Es-Sidikë.
OMER	Omerul Faruku.
OTHMAN	Othman ibnu Affan.
ALI	Ali Ebi Talib.
SEID	Seid ibnu Amir El-Xhumehij.
TUFEJL	Abdullah ibn Hudhafe Es-Sehmij.
UMEJR	Umejr ibnu Vehb.
BERRA	El-Berrau ibnu Malik El-Ensarij.
THUMAME	Thumame ibnu Uthal.
AMR	Amr ibnu Xhamuh.
UBEJDE	Ebu Ubejde ibnul Xherrah.
IKREME	Ikreme ibnu Ebi Xhehl.
ZEJD	Zejdul Hajr, Adij ibnu Hatim Et-Taij.
USAME	Usame ibnu Zejd.
SEID	Seid ibnu Zejd.
UMEJR	Umejr ibnu Sa`d.
XHAEFER	Xhaëfer ibnu Ebi Talib.
SEAD	Sead ibnu Vekasi.

HUDHEJFE	Hudhejfe ibnu Jemani.
HABIB	Habib ibnu Zejd El-Ensari.
REBIA	Reabia ibnu Ka`b.
ASIM	Asim ibnu Thabit.
HABAB	Habab ibnu Eretti.
SURAKA	Suraka ibnul Malik.
THABIT	Thabit ibnu Kajs El-Ensarij.
MUADH	Muadh ibnu Xhebel.
HALID	Halid ibnul Velid.
NUAJM	Nuajm ibnul Mes`udi.
UTBE	Utbe bin Gavzan.
ZUBEJR	Zubejr bin El-Avan.
HAMZA	Hamza bin Abdul-Muttalib.
ABAS	Abas bin Abdul-Muttalib.
KATADE	Katade bin Nuëman.
AMAR	Amar bin Jasir.
MUS`AB	Mus`ab bin Umejr.
EJUB	Ebu Ejub El-Ensarij.
SELMAN	Selman El-Farisij.
EBUDHERR	Ebu Dherr El-Gafari.
TALHA	Ebu Talha El-Ensarij.
ZIJAD	Zijad El-Harithij.

Redijall-llahu anhum - Zoti qoftë i kënaqur me ta!

A

AHMED	Emër i Muhamedit a.s.
ABDI	I Përkushtuar, devotshmëri.
ADIL	I drejtë.
ADNAN	Gjakpastër, fis i hershem arab.
ADVAN	I shpejt, i shkathët.
ADEM	Emër i një pejgamberi.
AFAN	I pastër, i pafajshëm.
AJET	Shenjë, dokument.
AJETULLAH	Shenjë, dokument i Zotit.
AJNI	Origjinal, natyral, i njëjtë.
AKIF	I qëndrueshëm.
AKIL	I mençur, i ditur.
ALI	I lartë, elegant.
AMAR	Jetëgjatë.
ARIF	Njohës i mirë, i kuptueshëm.
ASIM	Mbrojtës, ruajtës.
ATAULLAH	Dhuratë e Zotit.
ATIF	I dhimbshëm, mëshirues, i butë.
AVNI	Ndihmës.
ABIR	Kalimtar, udhëtar.
ASIL	Bamirës, i ëmbël.
ALIM	Dijetar.
AMIR	Banues , i mbushur me të mira.
ARAFAT	Kodra ku patjetër duhet të qëndrojnë hanxhinjtë natën e Bajramit.
ASHIR	I afërt, familjar.
AFIFE	I kujdesshëm, që nuk bën gabime, i pastër, i turpshëm.
AMIDE	Udhëheqës, dekan.

E

EBAN	I kjartë, i hapur, i çelur.
EBSEL	Me burrërori, më trimi.
EBSHIR	Përgëzo.
EBU BEKR	Sahab i Muhamedit a.s., Halifi i parë.
ETHIR	I zgjedhur.
EDIB	Edukues.
ERIB	I shkathtë, i zgjuar, i mençur.
ESIRË	I fortë me trup dhe çka moralin e lartë.
ESAD	Më i gëzuari, më i forti.
ESLEM	Ai që pranon fenë islame.
ESHXHEA	Më trimi, më guximtari.
ESHREF	Më fisniku, më i çmuari.
EKREM	Më fisniku, më i respektuari.
EKMEL	Më i ploti.
EMIRË	Udhëheqës.
EMINË	Fisnik.
ENES	I shoqërueshëm.
ENVER	Më i ndriçuari.
ENIS	I shoqërueshëm.
EJMEN	I djathtë.
EJUB	Emër i një pejgamberi.
EMRULLAH	Çështje e Zotit, urdhër i Zotit.



IHSAN	Bamirës.
IDRIS	Emër i një peygamberi.
ISBIR	Ai që i kupton gjerat në esencë.
ISLAM	Feja e pastër dhe e përsosur nga Zoti i madhëruar për tërë njerëzimin.
ISMAIL	Emër i një peygamberi.
ILHAM	Inspirim, frymëzim.
ISAM	I ruajtur prej gabimeve.
IZET	Fuqi, krenari.
IS`HAK	Emër i një peygamberi.
ISAMUDIN	Ruajtës i fesë.
IZEDIN	Fuqi feje, krenari feje.
ILJAS	Emër i një peygamberi.



USAME	Emër i sahabiut të Muhamedit a.s.
UMER	Emër i halifes së dytë në islam dhe njëherit sahab i Muhamedit a.s.
UBEJD	Shoku (sahabiu) i Muhamedit a.s.
UTBE	Shoku i Muhamedit a.s.
UMEJR	Shoku i Muhamedit a.s.

B

BASIL	Luan, trim.
BASIK	I ngritur.
BAKIR	I hershëm.
BASIM	Buzëqeshës.
BAHIR	Triumfues, fitues.
BEDRI	Hënë e plotë, shkëlqim.
BEDIL	Zëvendës.
BURAK	Shndritës, ndriçues.
BURHAN	Argument.
BESAM	Ai i cili buzëqesh shumë.
BESMAN	Ai i cili buzëqesh shumë.
BESHAR	Përgëzues.
BESHIRE	Përgëzues.
BESIRE	Vizionar, largpamës.
BEKIRE	I hershem për çdo gjë.
BILAL	Emër i muezinit të parë, i gjallë, i ujitur.
BELIGË	Orator, që flet rrjedhshëm.
BEHXHET	Gëzim, i lumtur, shkëlqim.
BAHRI	Detar.
BASRI	Ai që sheh.
BEDRUDIN	Shkëlqim feje.
BEHAUIN	Stoli feje, shkëlqim feje.
BURHANUDIN	Argument feje.

T

TALID	I vjetër, i kohëve të hershme.
TAHSIN	Zbukurues i çdo vepre.
TEKIJ	I devotshëm.
TESNIM	Burim (krua) i xhenetit.
TEMAM	I plotë.
TEVHID	Ai që pranon vetëm Allahun Zot.
TEFVIK	Shpëtim, pajtim në mes njerëzve.
TEJSIR	Lehtësues.
TAFIL	I vogël, foshnjor.
TAHIR	I pastër, ai që pastron.
TAJAR	Fluturues, pilot.
